

FLETA E PUNËS

RRËFIMET E EMIGRANITIT

[KËRKO FILMIN](#)

Punuar nga:

Gyltene Isufi	“Zenit”, Prishtinë
Jeta Rexha	“Hajdar Dushi”, Gjakovë
Merita Shala	“Mileniumi i tretë”, Prishtinë

Përshkrimi i Filmit

Filmi dokumentar “Rrëfimet e emigrantit” trajton fenomenin e migrimit gjatë periudhës së migrirove masive në vitin 2014 / 2016 në Kosovë. Papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike si dhe mungesa e perspektivës kanë ndikuar që shumë të rinjë të mësyjnë rrugët e Europës.

Migrimet e para të shqipëtarëve datojnë nga kohët më të lashta, por janë të njohura dyndjet masive pas vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Në kohën e re, janë të njohura dyndjet nga disa vise të Malësisë së Mbishkodës në drejtim të Dubrovnikut dhe Zarës (1726, 1732) nga Toplica (1877-1878), Jugu i Serbisë së sotme, pastaj në fillim të shekullit të XX, mes dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore për në Turqi,

ndërsa kah vitet '70-ta, të shekullit të kaluar, nga Kosova dhe ish - Jugosllavia, në mënyrë të organizuar ndodhën migrimet e përkohshme të punëtorëve në vendet e Evropës Perëndimore, kryesisht në Gjermani, Zvicër etj. Dyndjet e mëdha u përsëriten pas viteve '90-ta, ndërsa në formën më të vrazhdë ato masive ndodhen gjatë konfliktit të armatosur, që zgjati deri në gjysmën e vitit 1999.

Ka shumë teori apo pikëpyetje se “Pse” shumë njerëz në vitin 2014 filluan me u largu nga Kosova dhe jo vetëm disa, por mijëra njerëz, rreth 5 % e popullsisë së Kosovës. Qinda e mijëra gra, fëmijë, burra e të rinjë disa me autobus, disa në këmbë u nisën për një udhëtim të gjatë për në Hungari, Austri e Gjermani.

Mediat plasuan pamje me imazhe të kosovarëve duke udhëtuar për të gjetur një jetë më të mirë, por çfarë do të bëjnë kur të arrijnë atje?

Një burrë (prodhues filmash) i cili jeton në Shqipëri vendosi që të vjen në Kosovë në mars të vitit 2014 për të shikuar se çfarë po ndodhte. Pas një udhëtimi disa orësh për në Prishtinë ai filloi xhirimin e filmit dokumentar me pamje nga stacioni i autobusëve që paraqitnin njerëzit duke pritur për të udhëtuar jashtë Kosovës.

Mot i ftohtë, duke rënë borë, fëmijët, prindërit, të afërmit duke i dhënë lamtumirën njëri tjetrit, të cilët po iknin nga varfëria dhe papunësia, duke synuar për një jetë më të mirë, me ç'rast do të udhëtojnë legalisht për në Serbi dhe nga aty ilegalisht kalojnë kufirin e Hungarisë për në shtetet e BE-së, pamje që do të mbesin shumë gjatë në kujtesën e njerëzve dhe që shfaqin vërtetë trishtim.

Ky film dokumentar paraqet historinë e një të riu i cili ka vendosur që të migroj për në Evropë. Gjatë intervistës dhe xhirimit të filmit dokumentar Lundrimi ndihet nervoz.

“Dëshiroj të shkoj edhe unë në Gjermani si shokët e mi, ta provoj edhe unë fatin tem, se kështu nuk kam as unë të ardhme as kurgjë”.

Janë këto fjalët e të riut nga fshati Vërmicë, komuna e Malishevës, që si pasojë e mungesës së perspektivës për një mirëqenie më të mirë ekonomike e shtyn atë të migrojë në mënyrë ilegale nga Kosova. Shkalla e lartë e pa punësisë, niveli i ulët i kualitetit në arsim, niveli i ulët i kujdesit shëndetësor, mos zbatimi dhe respektimi i ligjit, korrupsioni, nepotizmi, etj, të gjitha këto kanë bërë që disa të rinjë po ashtu edhe familje të largohen nga vendi ynë.

“No money, no work” është fraza që më së shpeshti dëgjohej ato ditë, e këtë e thotë edhe Lundrimi i cili vendosi të udhëtoj për në Serbi dhe kaloj kufirin legalisht për t’u takuar atje me realizuesin e dokumentarit që e kishte njoftuar për nisjen e tij drejt Evropës.

Nervoza e Lundrimit shihet në fytyrën e tij dhe ikja nga vendi në vendin tjetër është një sfidë për të. Ai do të mësoj se si do të jetë jashtë vendit, do të jetë dëshpëruese, për çdo ndihmë të kërkuar mund të gjykon nëse do ta ndihmojnë ose do ta shtyjnë në telashe. Një jetë në një mjedis tjetër, ku duhet ta mbytesh një pjesë tënde me qëllim që të mbijetosh.

Si shumica e qytetarëve të Kosovës në mungesë të liberalizimit të vizave dhe lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian edhe Lundrimi është njëri ndër ata që nuk e ka bërë asnjë hap jashtë Kosovës, e që udhëtimi me autobus natën për në Serbi është vërtetë stresues.

Kjo ishte dita më stresues dhe më e gjatë për Lundrimin, edhe pse ai shfaq përsëri durim ani pse 10 milje rrugë për në Suboticë dhe se kalimi nga Serbia për Hungari përmes malit është e rrezikshme dhe mund të arrestohet nga policia.

“Kurrë nuk përfundon” ofshan Lundrimi gjersa tymi i cigarës j’a mbulon fytyrën e dëshpëruar.

Çfarë ndodhë me migrantët kur nuk kanë para më? Lundrimi është i dëshpëruar, pa para, dhe nuk ka para për taxi për ta dërguar në kufi.....

Lundrimi më në fund është me fat, takon një trafikant emigrantësh në stacion i cili ka ardhë më i marrë disa refugjatë...

Largimi i qytetarëve të Kosovës për në vendet e Bashkimit Evropian vazhdon edhe sot e kësaj dite, mirëpo përmes marrjes së vizave të punës. Sfidë për autoritetet shtetërore është riatdhesimi i të ikurve dhe ripranimi i tyre në bazë të standardeve që i kërkon BE-ja.

Tema Kryesore

Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale dhe kulturore.

Lënda Mësimore:

Sociologji, Psikologji, Edukatë Qytetare, Gjuhë Angleze

Njësia mësimore:

Sociologji:

1. Migrimet e popullsisë
2. Varfëria dhe pa punësia

Psikologji:

1. Depresioni
2. Stresi
3. Ankthi
4. Kriza e identitetit

Edukatë Qytetare:

1. Pasojat sociale papunësia dhe varfëria

Gjuhë Angleze:

1. Komunikimi, kapitulli: Migrimi

Objektivat:

Sipas kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë:

- Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore
- Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës

Fushat e Kurrikulës:

Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim

Përshtatshëm për:

Shkallën: 5, 6

Pikat e diskutimit pas shfaqjes së filmit:

1. Migrimet e shqipëtarëve në periudha të ndryshme kohore (Historiku i migrimeve)
2. Motivet që ndikojnë në migrimin e njerëzve
3. Migrimet e jashtme / brendshme/ përkohshme/ përhershme
4. Faktorët (shkaktarët) e migrimeve
5. Pasojat e migrimeve
6. Integrimi / Riintegrim
7. Asimilimi dhe format e shprehjes së tij
8. Mungesa e perspektivës te të rinjtë

9. Orientimi në tregun e punës

10. Ballafaqimi me kultura / realitet tjetër

Aktivitete në lidhje me filmin:

Evokim – Brainstorming

1. Tendencat e njerëzve për lëvizje gjeografike dhe sociale
2. Cilët janë faktorët që ndikojnë që individi apo grupi të migrojnë?
3. Pasojat e migrameve: demografike, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike.
4. Asimilimi dhe shembuj të funksionimit të modelit të asimilimit

Realizim – ndahen nxënësit në grupe

1. Migrimet për shkaqe / arsye shkollimi / arsimimi si dhe pasojat
2. Migrimet për shkaqe / arsye ekonomike / politike si dhe pasojat
3. Migrimet për shkaqe / arsye konflikti / luftëra si dhe pasojat
4. Migrimet për shkaqe sociale / kulturore si dhe pasojat

Reflektim - Pesëvargëshi

1. Emër
2. Dy mbiemra
3. Folje

4. 1 fjali / mesazh

Shkrim i lirë:

Arsyet pse duhet ne duhet të qëndrojmë në Kosovë?

Kompetencat:

Nxënës i suksesshëm

Mendimtar kreativ

Komunikues efektiv

Filma tjerë të rekomanduar:

[Fire at Sea](#) nga Gianfranco Rosi: Ky film i vlerësuar tregon jetën e njerëzve në ishullin Italian Lampedusa, krahas jetës së migrantve nga Afrika dhe Lindja e Mesme. Filmi tregon për jetën e tyre, pa marrë anë por duke kërkuar nga shikuesit të formojnë mendimin e tyre.

[Sharaf - An Animated Documentary](#) nga Hanna Heilborn dhe David Aronowitsch: Sharafi 17 vjeçar është njëri nga shumë refugjatët, të cilët kanë arritur në Gran Canaria viteve të fundit. Historia e Sharafit u jep zë atyre të cilët ia dolën të jenë gjallë nëpër këtë rrugëtim, por edhe atyre që vdiqën në det.

Literatura e rekomanduar:

[The Penguin Book of Migration Literature: Departures, Arrivals, Generations, Returns](#) nga Dohra Ahmad

[The Age of Migration](#) nga Mark J. Miller dhe Stephen Castles

—